



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 396/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.06.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të BOE “B-93” sh.p.k. & “Totila” sh.p.k. & “Rafin Company” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-16406-04-02-2019, me objekt: “*Lot.4 “Rikonstrukcion i disa QSH-ve në qarqet Gjirokastrër, Vlorë dhe Fier*”, me fond limit 95,246,384.91 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ankimues: BOE “B-93” shpk & “Totila” shpk & “Rafin Company” shpk
Adresa: Lagjia “8 Shkurti”, Rr. “Andon Doro”, Fier.

Autoriteti Kontraktor: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Adresa: Rruga e Kavajës, nr. 1001, Tiranë.

Baza Ligjore: *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 03.04.2019, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me nr. REF-16406-04-02-2019, me objekt: “Lot.4 “Rikonstruksion i disa QSH-ve në qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier”, me fond limit 95,246,384.91 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

II.2 Në datën 08.05.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 27.05.2019, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “B-93” & ”Totila” & ”Rafin Company” shpk	76,130,392.00 lekë, Skualifikuar;
2. “Colombo” shpk	76,965,533.00 lekë, Skualifikuar;
3. ”Ndregjoni” & ”Vllaznia” & ”Kthella” shpk	77,736,607.00 lekë, Skualifikuar;
4. “Mane/S” & ”BE-IS” shpk	79,980,547.00 lekë, Kualifikuar;
5. “Gjikuria” shpk	88,031,781.00 lekë, Kualifikuar;
6. “Sireta-2F” shpk	88,751,804.00 lekë, Kualifikuar;
7. “Ante Group” shpk	90,677,792.00 lekë, Kualifikuar;
8. “Air Komponent” shpk	pa ofertë ekonomike, Skualifikuar;
9. “Arkonstudio” shpk	pa ofertë ekonomike, Skualifikuar;
10. “Elda-VI” shpk	pa ofertë ekonomike, Skualifikuar;

II.4.Me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar BOE “B-93” shpk & “Totila” shpk & “Rafin Company” shpk për skualifikimin e ofertës së tij, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, me arsyetimin si më poshtë vijon:

“Në preventivin e paraqitur nga ky BOE, vlera e kontrolluar e totalit të preventivit rezulton 76,130,392, ndërsa vlera e paraqitur nga ky BOE është 78,208,541. Për këtë rast, në zbatim tëoikës 4 të nenit 66 të VKM 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, diferenca e gabimeve në total është më e madhe se 2 % e vlerës së ofruar, konkretisht 2.66 %”

II.5.Në datën 30.05.2019, BOE “B-93” shpk & “Totila” shpk & “Rafin Company” shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e autoritetit kontraktor për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të vendimit Nr. 1851/42 Prot. datë 07.06.2019, autoriteti kontraktor e ka pranuar ankesën e paraqitur nga BOE “B-93” shpk & “Totila” shpk & “Rafin Company” shpk, si dhe duke vendosur kualifikimin e ankimuesit.

II.7.Në datën 10.06.2019, BOE “B-93” shpk & “Totila” shpk & “Rafin Company” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.8.Në datën 25.06.2019, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1851/60prot., datë 21.06.2019, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e BOE “B-93” shpk & “Totila” shpk & “Rafin Company” shpk, mbi skualifikimin e ofertës së tij, nga shqyrtimi i dokumentave që Komisioni i Prokurimit Publik disponon në lidhje me këtë procedurë prokurimi, u konstatua si vijon:

III.1.1.Autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.1851/60prot., datë 21.06.2019, kthen përgjigje, duke informuar se pretendimi i BOE “B-93” shpk & “Totila” shpk & “Rafin Company” shpk në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij, është shqyrtuar dhe është marrë parasysh, e si rrjedhim ankesa e tij është pranuar. Gjithashtu konstatohet se, në datën 10.06.2019, autoriteti kontraktor ka bërë rivlerësimin në SPE, duke e kualifikuar BOE ankimues.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se ankesa e BOE “B-93” shpk & “Totila” shpk & “Rafin Company” shpk është pranuar nga autoriteti kontraktor, ndaj nuk do të merret në shqyrtim në themel pasi nuk ekziston më si objekt ankimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pushojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-16406-04-02-2019, me objekt: “*Lot.4 “Rikonstruktion i disa QSH-ve në qarqet Gjirokastër, Vlorë dhe Fier*”, me fond limit 95,246,384.91 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 08.05.2019, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “B-93” shpk & “Totila” shpk & “Rafin Company” shpk
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1057 protokoli Datë 10.06.2019;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha